



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr. _____, datë _____

PËR

**PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE
TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Pjesëmarrjen e 2 (dy) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), në Republikën e Sudanit të Jugut.

Neni 2

Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është mbështetja dhe dhënia e kontributit në Shtabin Rajonal të Forcës Mbrojtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Juba, kryeqytet i Republikës së Sudanit të Jugut.

Neni 3

Ushtarakët, të cilët do të marrin pjesë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS), për ditët e qëndrimit në këtë mision do të marrin,

veç pagës mujore, edhe dietë ditore për vështirësi shërbimi, në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I MBROJTJES

OLTA XHAÇKA